



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 29.09.2021,
duke filluar në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Egzon Azemi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Blerand Stavileci.

Munguan: Fadil Gashi dhe Genc Sherifi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Leutrim Retkoceri, asamblist.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Egzon Azemi tha se QKUK ka bërë një kërkesë në Komunë, që me ia dhënë një parcelë në Vranidoll për largimin e placentave, mbetjeve prej operacioneve.

Agim Kuleta, kryesues, bëri të ditur se e ka dërguar në drejtori kërkesën, por nuk ka njojuri se a ka diçka lidhur me këtë çështje.

Egzon Azemi theksoi se ne kemi kërkuar përgjigje vazhdimisht nga Komuna e Prishtinës, por ende nuk kemi marrë asnje përgjigje.

Sami Boroci pyeti se a bëhet largimi i placentave nga operatori ekonomik me kontraktor apo prej QKMF-së.

Leutrim Retkoceri dha sqarime, duke thënë se në QKUK ka qenë një kompani private e kontraktuar, e cila këto mbetjet i ka dërguar, p.sh. në një qendër në Ferizaj i ka djegur, e tani kush është ka kërkon a kompania QKUK-ja apo Ministria e Shëndetësisë se na duhet me sqaruar se QKUK-ja nuk mundet mi menaxhuar këto.

Egzon Azemi theksoi se kërkesën e ka bërë QKUK-ja.

Vala Peshku u shpreh se nëse kërkojnë parcelë, kjo nuk është problem me ju dhënë, por çka do të ndodhë tutje, kush e kryen djegien etj., ideja është çka ndodhë tutje me atë parcelë nëse nuk kemi ne një shpjegim prej tyre se si ka me u bërë shkatërrimi i këtyre mbetjeve.

Faqe 1 nga 5

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se informata të plota nuk kemi, andaj duhet shikuar deri ku kanë shkuar ata.

Agim Gashi tha se ne nuk jemi ata që e caktojmë atë pikë të rendit të ditës, ne iniciojmë, qeveria komunale nëse ka kërkesë le ta përgatisë materialin, në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit.

Sami Boroci theksoi ne në parim jemi për me nda këtë pronë, por çështje që duhet me u trajtuar është lloji se çfarë kërkese është, a është kërkesë e QKUK-së dhe qysh ka me u trajtuar ajo, a ka me menaxhuar operatori privat që e ka një kontratë të caktuar. Unë nuk e kam problem me ndarë këtë parcelë për QKUK-në, por mendoj se duhet me shikuar ministri ku e ka kërkuar këtë pjesën në Vranidoll dhe duhet me shikuar edhe këtë pjesën tjetër se a ka mendim të përfilltë të banorëve, mendoj para një vendimi të Kuvendit është dashur me iu nënshtruar një diskutimi ndoshta me banorët, përfaqësuesit e kësaj pjese.

Agim Gashi tha se lokacionet e tilla caktohen në koordinim me Ministrinë e Ambientit dhe të Shëndetësisë, sepse janë mbeturina speciale, janë mbeturina sikurse mbeturinat e rrezikshme që trajtohen, në atë standardët trajtohen edhe mbeturinat njerëzore.

Agim Kuleta, kryesues, tha ju tregojmë që është iniciuar këtu dhe mandej e shikojmë se deri ku kanë shkuar drejtoria që është duke u marrë me këtë punë edhe me aspektin e banorëve edhe aspektin me Ministri deri ku kanë mbërri.

Egzon Azemi bëri të ditur se propozimi tjetër është çështja e Ndërmarrjes Publike Banesore, tanë me problem të ri, faktikisht me dy probleme, çka është shumë shqetësuese, aty është rrëzuar objekti në ora 5 të mëngjesit me material të asbestit, në lagjen "Lakërishta", në një lagje jashtëzakonisht të banuar, dhe kurrfarë përgjegjësie askush nuk jap, kjo është shqetësuese çka po ndodh, të paktën aksionarët me dhënë një raport, me pasur si pikë diskutimi.

Vala Peshku tha se kjo çështje është për organet e rendit, cili është impakti nëse diskutojmë ne në Kuvend, çka mbërrijmë ne, kjo është pyetja ime.

Egzon Azemi tha vetëm të ndërmarrim diçka në këtë çështje. Lokacioni është vendim i Kuvendit komunal gjatë periudhës së LDK-së, gjithë këtë pjesën që është rrëzuar kjo shtëpia, është Vendim i Kuvendit komunal i vitit 2004, ku ia ka dhënë objektit B/3, "Lakërishtë", me çfarë procedure tanë je duke ia marrë atë pronë me bërë për ndërtim, deri tash ata e kanë shfrytëzuar si park.

Agim Gashi pyeti se a është pronë komunale.

Egzon Azemi dha sqarim.

Agim Kuleta, kryesues, tha se ky nuk është propozim që i shkon kryetarit, realisht mundesh me propozuar në Kuvend dhe e shohim se a po hyn si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë

R E N D D I T E :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa;

2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky rend dite.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime, duke cekur se sipas qarkores së parë të Ministrisë së Financave, është kërkuar që rreth përgatitjes së buxhetit për vitin 2022, duhet me i dhënë prioritet projekteve të cilave nuk kanë filluar, duke pasur parasysh pandeminë e çështje të tjera, duke i pasur parasysh të gjitha problemet, na kanë kërkuar të gjitha organizatave, jo vetëm komunave, që në buxhetin e vitit 2022 mos të futen projekte të reja dhe të mbeten projektet të cilat veç janë miratuar një herë prej këtij Kuvendi. Shumica janë projekte të viteve të më hershme, konkretisht të vitit 2020 – 2021, të cilat kanë mbetur edhe disa projekte të reja të cilat nuk e di se qysh kanë me i marrë parasysh Ministria e Financave, ku për projekte të reja është kërkuar me u zbatuar Udhëzimi administrativ i vitit 2019, ku për secilin projekte ka me u zbatuar çështja e shpronësimit dhe kostojë e secilit projekt.

Agim Gashi tha se kur diskutohet buxheti i propozuar, është dashur të jenë të gjithë përfaqësuesit e drejtive që të jepin sqarime, sepse filli i propozimeve të projekteve vije nga drejtore, nga diskutimet publike, i inkorporojnë, i seleksionojnë, i propozojnë hynë në Qeveri, miratohet propozimi, drafti, dhe vjen te ne.

Këtu në dokument përveç çështjeve teknike që i vërejta, është mirë deri në Kuvend me u përmirësuar disa gjëra, si p.sh. thuhet ndërtimi i parqeve është te Drejtoria e Kulturës, të hiqet kjo nga lista e mos të jenë dy propozime, d.m.th. për të njëjtën përbajtje të projekteve. Po ashtu ceku se kanë qenë një varg projektesh, që ndoshta ka projekt qe 8 vjet e nuk është përfunduar, si p.sh. marrëveshja ndërkombëtare që e kemi pasur për kanalizim dhe implementim te Liqeni i Badocit, që kalon nëpër fshatin Mramor, ku faza e parë është kontraktuar, faza e dytë është ndërprerë 50% dhe fazën e tretë nuk po e shoh që është kështu, qe tetë vite nuk po mundeni me

kryer një kanalizim. Po ashtu, janë disa propozime që i kam dhënë unë dhe nuk po i shoh, si ndërtimi i trotuareve, zgjerimi i rrugëve dhe vendbanimeve të caktuara, nuk e di a ka hyrë rruga "A", nëse jo, shumë keq, duhet me qenë kanalizimi i shtratit të lumbit për Llukar, se nuk mjafton vetëm kanalizimi.

Leutrim Retkoceri sa i përket projektit të rrugës "A", që janë ndarë 800 mijë euro, plus 200 mijë euro prej të hyrave vetanake, 1 milion euro është projekti, mbi 12-13 prona ishin private, që nuk kishte gjasa as me u kryer edhe pse kryhet kolektori.

Agim Gashi dha sqarime se kjo çështje është rregulluar me ndryshimin e Planit të hollësishëm herën e fundit, krejt këto pjesë i kemi integruar në etazhitet, d.m.th. është rritur etazhiteti për me mundur me bërë shpronësimin pa pare.

Sami Boroci tha se ne jem dëshmitarë që shumë projekte thjeshtë janë në exell dhe nuk ka asnë shpjegim, kurrfarë analize nëse janë të realizueshme ose jo, qoftë nëse ka konteste pronësore, qoftë gjyqësore etj., kështu që drejtoresha pati thënë se nuk munden me u regjistruar.

Valbona Ahmeti - Makolli tha nëse nuk e keni ju, dërgohet i gjithë dokumenti për Kuvend, ai është publik, aty shkruante asnë projekt nuk mund me hyjë nëse Komuna nuk deklaron a ka çështje pronësor apo jo.

Sami Boroci u shpreh se shumë projekte specifike të cilat po i shoh, për mendimin tim, duke i njobur ato rrethana të atyre projekteve, siç po shihen këtu nuk ka gjasa me u realizuar.

Valbona Ahmeti - Makolli, dha sqarime për këtë.

Halim Halimi shprehu mendimin se prej fillimit kjo qeveri nuk ka punuar, nuk po punon, kot e bën buxhetin 90 milionë euro edhe sa e patëm vitin e kaluar, mirëpo shumë projekte kapitale me rëndësi nuk janë realizuar edhe tani na kemi me i propozuar projektet, kjo qeveri dihet se nuk ka me i realizuar se nuk ka më mandat.

Edhe parafolësit e cekën se ata që duhet me qenë edhe për rregullimin e çështjes pronësoro - juridike dhe çështjeve tjera, gjatë gjithë viti nuk kanë ardhur asnë herë. Unë tani e kam një pyetje me bërë, po e shoh te investimet kapitale, investimi i rrugës "Svirca", 150 mijë euro, unë nuk e di ku gjendet kjo rrugë, nuk e kemi drejtorin këtu me dhenë sqarime.

Leutrim Retkoceri tha se nuk e di sa mundemi me arritur me bërë presion, mirëpo ne nuk duhet me lejuar që ky buxhet me kaluar në praninë e vetëm të drejtoreshës së Financave, pa qenë drejtorët që e kanë dizajnuar buxhetin për drejtorin e tyre, prej shumës ma të madhe drejtori i investimeve kapitale, pa marrë parasysh se a ka qenë pandemi, fushatë, krizë e tjera, se buxhetin e ke me Ligj me kaluar në shtator, nuk kemi me kaluar, le të vijnë le t'i arsyetojnë se kjo nuk është urgjente diçka, kushdo që të vjen shërbën arsyetimi i tij publik për ato projekte.

Vala Peshku tha ose ju japim hapësirë me bërë diçka qeverisë së ardhshme, ose ia marrim të drejtën me bërë.

Agim Gashi tha çdo propozim që miratohet me 26 vota e ndryshon buxhetin.

Leutrim Retkoceri u shpreh se e ndryshon, nëse vijnë drejtorët ia ndryshojmë projektet.

Agim Gashi tha se kam një sqarim, pyetje për drejtoreshën. Projektet që kanë qenë vitin e kaluar dhe nuk janë proceduar, d.m.th. nuk kanë arritur të shpallen në tender, a shkojnë bashkë me bartjen vitin e ardhshëm.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se nuk besoj që munden me kaluar në bartje nëse nuk e kanë një numër të prokurimit, nuk e pranon Ministria.

Agim Gashi tha se vitin e kaluar kemi pasur dy vite me radhë nga 500 mijë euro për rrugën "A" dhe kanë qenë 300 mijë euro për ujësjellësin në fshat për zgjerimin e ujësjellësit, ku asnjëra nuk janë proceduar, as nuk janë hartuar projektet. Atëherë këto a mbesin në bartjen e buxhetit të njëjtë, apo duhet me i futur prapë në kod të ri në këtë buxhet.

Valbona Ahmeti - Makolli, tha sa kam njohuri unë për rrugën "A", ne e kemi marrëveshjen me Ministrinë.

Agim Gashi kërkoi që brenda mundësive, para mbledhjes së Kuvend, me sqaruar këtë problem dhe në Kuvend me na njoftuar.

Valbona Ahmeti - Makolli dha sqarime.

Agim Gashi tha e kemi buxhetin e vitit 2021, shikojeni, ato projektet që nuk janë shpall fare nuk janë përgatitur, ato a mbesin në dokumentin e bartjes apo na duhet me i planifikuar tani, sepse nuk mundemi me lënë Komunën e Prishtinës pa asnjë metër gjatësi rritje të ujësjellësit.

Valbona Ahmeti-Makolli theksoi se drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale po thotë duhet me pasur bashkëpunim edhe me ujësjellësin, sepse nuk mundemi me bërë vetëm, vjen ai dhe ju shpjegon, unë nuk mundem as këtu as në Kuvend mu përgjigjur në pyetjen që po thua ti, përgjigjet drejtori i Investimeve Kapitale.

Leutrim Retkoceri, kjo nëse e ka për detyrë me bërë buxhetin e ai nuk është me arsyetuar, nëse nuk vjen me i arsyetuar e marrim të drejtën me ja ndryshuar dhe me i shtyrë përparrë propozimet të cilat mendojmë se janë më të mira se këto.

Vala Peshku tha se nëse nuk vijnë drejtorët, nuk ua votojmë buxhetin.

Kryesuesi konstataoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022-2024 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 12 :00.

Procesmbajtësja
Shyrete Islami

Faqe 5 nga 5

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta

